



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA**

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2019

Njoftim

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; te ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë.16.07.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 18.12.2019, ora 11:00** në sallën e Mbledhjeve të ERE-s do të zhvillohet mbledhja e radhës e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

1- Në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Wonder” sh.p.k dhe kërkesën e shoqërisë “Hydropower-SAS” sh.p.k, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 171, datë 07.11.2019 (Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes; Drejtoria e Çështjeve Ligjore)

2- Mbi shtyrjen e periudhës tranzitore për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), tek shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a (O.S.SH sh.a); Licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a)” (Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes)

3- Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2019 (Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve)

KRYETARI

Petrit AHMETI